

VENDIM
Nr. 217, datë 4.7.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL
TECHNICAL MECHANICS” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1832/1 prot., datë 3.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1832 prot., datë 22.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “c” dhe pikën 2.5.

Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim: neni 9, formati dhe dokumentacioni për aplikim; pika 1, dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë.

Pika 1.3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organit tatimor përkatës.

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion mbështetës në kuadër të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj. Gjithashtu, bilancin dhe raportin e auditimit për vitin ushtrimor 2022, i cili është depozituar fotokopje, dhe duhet depozituar në kopje të noterizuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti